

STATUT
I
SHOQERISE ANONIME
“CONTINENTAL GROUP” SHA

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia

Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 27/08/2012, ne aksioneret e Shoqërisë Anonime, me emrin “**CONTINENTAL GROUP**” **SHA**, riformulojme statutin e saj, si më poshtë vijon:

Aksionerët e shoqërisë janë:

1. **Luigj Alijaj**, i datëlindjes 05.11.1959, me numër identifikimi 027802077
2. **Shefqet Kastrati**, i datëlindjes 05.06.1961, me numër identifikimi 027847599

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Import dhe tregtim me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera, stacione të shitjes me shumicë dhe pakicë të karburanteve , lëndës djegëse për ngrohje, rafineri e prodhimit të naftës bruto, veprimtari transporti detare dhe tokësore të naftës dhe gazit, transport dhe shitje e mallrave të ndryshme si pjesë këmbimi, lëndë të para, veprimtari turistike si hoteleri, bar, restorant, piceri, shërbime mjekësore, agjensi doganore, servise dhe autoshkolla, hapje linjash të ndryshme. Transport mallrash të ndryshme si dhe shfrytëzim i mënyrave të transportit të çfarëdo lloji qofshin të tokës, detit dhe të ajrit. Servise automjeteve dhe autoshkolla. Aktivitet inxhinieringu. Konsulencë ekonomike, financiare, tregtare, etj. Hapje linjash të ndryshme prodhimi, etiketimi, amballazhimi, numërimi, peshim mallrash ushqimore, industriale etj. Shoqëria ka si objekt dhe të gjithë aktivitetin që lidhet me fushën e ndërtimit si gërmime dheu, ndërtime civile dhe ekonomike, prodhim dhe tregtim materiale



inerte, ndërtim rrugësh, urash, vepra arti etj. Transport mallrash për vete dhe për të tretët..Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, import eksport të mallrave industriale, tregtim pjesë këmbimi për automjete dhe për mjete të tonazhit të lartë si dhe të blejë, të shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat

Neni 4: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë: **Vore, Tiranë**

KREU II

Kapitali i regjistruar

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **156.350.000(Njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e treqind e pesëdhjetëmijë)** lekë, i ndarë në 6.254 aksione të zakonshme, me vlerë nominale 25.000 lekë secili. Kontributi i aksionerëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Luigj Alijaj është zotërues i 3.127 aksioneve, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë. **Shefqet Kastrati** është zotërues i 3.127 aksioneve, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.

Neni 6: Pagesa e kuotave

Administratorët mund t'i kërkojnë ortakëve pagimin e kontributeve në para të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre. Në rast të mos shlyerjes së kontributeve, sipas përcaktimit të



administratorit, personi përgjegjës do të paguajë një kamatë vonesë mbi shumën e papaguar me interes prej 4% në vit.

Neni 7: Kalimi i kuotave

Kalimi i kuotave dhe i të drejtave që rrjedhin prej tyre, mund të bëhet me :

kontratë shitblerje,

dhurim,

trashëgimi

çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 8: Aksionet dhe zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit

- a) Kur emetohen aksionet e reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të rinj, por me çmim jo më të lartë se ai i ofruar për aksionarët e rinj
- b) Vendimi për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë merret me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme.

KREU III

Asambleja e përgjithshme

Neni 9: Të drejtat dhe detyrimet

- a) Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendim marrës i shoqërisë. Në kompetencë të saj janë të gjitha vendimet e përcaktuara nga neni 135 i ligjit 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- b) Në vendim marrjen e saj Asambleja e Përgjithshme shqyrton të gjitha dokumentat apo raportet përkatëse të lëshuara nga administratori, Këshilli Mbikëqyrës apo Eksperti Kontabël i Autorizuar.

Neni 10: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- a) Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori të paktën 2 herë në vit.

- b) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një shkrese dërguar çdo aksionari me postë të zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Neni 11: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- a) Në rastin e ceshtjeve që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionaret, që zoterojnë më shumë se 30% të aksioneve me të drejtë vote. Kur Asambleja duhet të vendosë për ceshtje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të Ligjit 9901” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionaret që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë personalisht ose votojnë me shkrese ose mjete elektronike sipas parashikimit të nenit 142 të Ligjit 9901” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- b) Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionerëve që marrin pjesë në votim në lidhje me ceshtjet që kanë të bëjnë me ndryshimin e Statutit, zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin dhe prishjen e shoqërise.
- c) Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga administratori nëse është e thirrur prej tij. Nëse Asambleja e Përgjithshme është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesohet nga një aksionar i caktuar nga Këshilli Mbikqyrës.
- d) Administratori ose anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, pavarësisht se nuk janë aksionar, kanë të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrin fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve.
- e) Asambleja vendos në përgjithësi me votim të hapur. Vendimet për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës merren me votim të fshehtë.

Neni 12: Votat e Pjesëmarrësve

- a) Çdo aksion i jep aksionarit të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar të drejtën e një vote.



- b) Asnjë aksionar nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme apo në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me aksionet, që ai disponon.

Neni 13: Emërimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar

Me propozim të Këshillit Mbikëqyrës dhe vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Ekspert Kontabël i Autorizuar i shoqërisë është Shoqëria Euro-Audit, Consultancy, co

- a) Gjatë mandatit të tyre, ekspertët kontabël të autorizuar mund të largohen nga detyra vetëm për shkaqe të arsyeshme.
- b) Eksperti Kontabël i Autorizuar i raporton Këshillit Mbikëqyrës, për çështje kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe në veçanti për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar

Neni 14: Emërimi i Administratorit

- a) Këshilli Mbikëqyrës zgjedh, për një periudhë 3 vjeçare si Administrator, **Z. Shefqet Jata**, datëlindjes 01.07.1950, me numër identifikimi 024501488
- b) Këshilli Mbikëqyrës mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga kontrata e punës e lidhur me shoqërinë.

Neni 15: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë,
- b. të përfaqësojë shoqërinë,
- c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- d. të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë,
- e. të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë,



- f. të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë,
- g. të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe statut

Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit Mbikëqyrës nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorit, të cilat do të mbeten njëjloj të vlefshme sikur ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë. Administratorët skualifikohen dhe shkarkohen në rastet e përcaktuara në ligj

Neni 16: Mbledhjet e Administratorit

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë proces verbalet e të gjitha takimeve të kryera nga ai, si dhe të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve të aksioneve të klasave të ndryshme ose mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, në të cilat ai ka marrë pjesë.

KREU V

Këshilli Mbikëqyrës

Neni 17: Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Asambleja e Përgjithshme emëron jo më pak se tre persona fizikë në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe kryetarin e tij.

Asambleja e Përgjithshme, e shoqërisë CONTINENTAL GROUP SHA, emëron si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të kësaj shoqërie, personat e mëposhtëm:

- **Luigj Alijaj**, i datelindjes 05.11.1959, me numër identifikimi 027802077
- **Shefqet Kastrati**, i datelindjes 05.06.1961, me numër identifikimi 027847599
- **Gani Kastrati**, i datelindjes 15.11.1952, me numër identifikimi 031107938
- **Ramazan Hoda**, i datelindjes 20.03.1959, me numër identifikimi 025139379

dhe si Kryetar të Këshillit Mbikëqyrës, **Z. Ramazan Hoda**

Kohëzgjatja në detyrë e këtyre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe e Kryetarit të tij është jo më shumë se 3 vjet.

Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë persona të tjerë zëvendësues ose shtesë, si anëtarë të tjerë të këtij organi.



Neni 18: Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

- a) Këshilli Mbikëqyrës nuk merr pjesë në administrimin e shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratorët dhe kontrollon pajtueshmërinë me kërkesat e ligjit dhe të statutit. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund t'i delegohen administratorit.
- b) Këshilli Mbikëqyrës mund të krijojë komitete të veçanta për problemet e menaxhimit të shoqërisë.

Bazuar në propozimet e këtyre komiteteve, Këshilli Mbikëqyrës:

- i paraqet propozime Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me emërimin e administratorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar.
- Harton raportin mbi ecurinë e veprimtarisë dhe ia dorëzon atë Asamblesë së Përgjithshme.
- Harton raportin vjetor për drejtimin e brendshëm të shoqërisë dhe kualifikimin e administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe e bën publik atë.

Neni 19: Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

- a) Këshilli Mbikëqyrës thirret nga kryetari i tij të paktën 2 herë në vit. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës thirret nëpërmjet një shkrese dërguar çdo anëtar të tij me postë të zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.
- b) Administratori, aksionarët që zotërojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar, apo të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës kanë të drejtë të thërrasin mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës nëpërmjet kryetarit të tij ose edhe pa ndërmjetësimin e tij.
- c) Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës konsiderohen të vlefshme kur në të marrin pjesë të paktën 4/5 e numrit të anëtarëve të tij. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës konsiderohen të vlefshme kur ato janë mbështetur nga më shumë se 1/2 e anëtarëve të pranishëm.



- d) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës është njëlloj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në një mbledhje të rregullt të tij.

KREU VI

Dividendët dhe ndarja e fitimit vjetor

Neni 20: Dividendët

- a) Dividendi është pjesa që i takon secilit aksionar nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.
- b) Fitimet vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara nga ligji 9228, datë 29/04/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- c) Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t’u shpërndajë aksionarëve dividendin në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë.
- d) Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet aksionarëve si dividend, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

KREU VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 21: Prishja dhe likuidimi

- a) Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator i cili, administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit,
- b) Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet aksionarëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë.



Neni 22: Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

Neni 23: Përfundimi i likuidimit

- a) Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë
- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Neni 24: Dispozitat e fundit

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij statuti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive aksionare.

FUND

Aksionerët e shoqërisë

Luigj Alijaj

LUIGJ ALIJAJ



Shëfqet Kastrati

